



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 31 Dt. 13.02.2017

“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “EUROBIZNES” SH.P.K.

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim të subjektit “EUROBIZNES” sh.p.k.,me propozim të A.B.U Drin- Bunë , miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore,Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “EUROBIZNES”sh.p.k., me administrator Z.Veli Islami, për përdorim të burimit ujor Përroi i Mullirit për prodhim energjie elektrike në Lusën , Njësia Adm. Ujmishit,Bashkia Kukës, Qarku Kukës. Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC LUSNA 3 do të ketë këto të dhëna:

Për ndërtimin e H/C Lusna 3 nuk do të ketë vepër marrje në Përroin e Mullirit pasi do të shfrytëzohet uji i shkarkuar nga godina e H/C Lusna 2

Koordinatat e shkarkimit të H/C Lusna 2 : X – 44 49 384; Y –46 43 126; Z - +810 m;
Koordinatat e godinës së centrali: X – 44 48 523; Y –46 42 976; Z - +440m;
Koordinatat e pikës së shkarkimit : X – 44 48 523; Y –46 42 976; Z - +440m;
Prurja mesatare vjetore e burimit : Q mes= 0.084 m³/sek;
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 0,25m³/sek;
Prurja ekologjike: Q_{ekol}= 0.017 m³/sek;
Prurja që shkarkohet: Q= 0.25 m³/sek.

2- Autorizimi i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

